

VENDIM
Nr.583, datë 10.8.2011

PËR KALIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME KANTIERI DETAR Durrës DHE
AKUATORIUM NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AUTORITETIT PORTUAL
DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, e 13, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të nenit 19 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9130, datë 8.9.2004 “Për autoritetin portual”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Portual Durrës të pasurisë së paluajtshme publike, shtetërore, me emërtimin ish-Kantieri Detar Durrës, ndërtime të ngritura mbi të, dhe Akutorium, me sipërfaqe dhe planimetri sipas aneksit 1, bashkëlidhur, pa të drejtë vendosjeje barre siguruese, në kuptim të Kodit Civil, dhe përjashtuar nga procedurat e shpronësimit në favor të të tretëve.

2. Pasuria e paluajtshme me emërtimin ish-Kantieri Detar Durrës dhe Akutorium, t’i nënshtrohet përmirësimeve në dobi të zhvillimit të masterplanit të miratuar me vendimin nr.546, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masterplanit për zhvillimin e Portit të Durrësit”, dhe zgjidhjeve efektive që rrisin rentabilitetin e portit.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Autoriteti Portual Durrës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha